



# Qytetarë të bashkuar, më mirë mbrojnë **INTERESIN PUBLIK**

Mësimet e nxjerra për projektin "Lidhi pikat"



## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje	5
2. Koalicioni qytetar për qeverisje më të mirë dhe angazhim më të madh të qytetarëve në shoqëri	6
3. Gazetaria me interes publik, sërish në fokus të mediave	24
4. Tema të përbashkëta që shqetësojnë qytetarët e rajonit të Ballkanit Perëndimor	31
5. Pjesëmarrja e barabartë e grave	34
6. Histori suksesi: Sa na kushtojnë hidrocentralet e vogla?	42
7. Histori suksesi: Rampë për paligjshmërinë në urbanizëm dhe ndërtim	49
8. Pandemia e Kovid-19 imponoi dinamikën e vet dhe tema të ndryshme me interes publik	54
9. Metodologjia	58
10. Projekti përmes numrave	60

# 1 HYRJE

Instituti për Studime të Komunikimit (ISK) zbaton projektin “Lidhi pikat”, përmes të cilit kemi krijuar një koalicion qytetar që i mundëson sektorit të shoqërisë civile, akademisë, mediave dhe institucioneve publike të punojnë së bashku për qeverisje më të mirë.

Gjatë projektit jemi fokusuar në mbrojtjen e interesit publik dhe forcimin e gazetarisë me interes publik. Duke i dhënë hapësirë pikëpamjeve të ndryshme, ne ngritëm çështje që ishin të marginalizuara në mediat tradicionale dhe i ndihmuam ato të bëhen kryesore në raportimin mediatic.


Strategjia jonë kryesore për projektin “Lidhi pikat” ishte bashkëpunimi në shumë nivele midis palëve të ndryshme të interesit, duke përdorur një sërë mjetesh, të cilat dhanë rezultate të mira:

- Lidhja e shoqërisë civile, komunitetit akademik, mediave dhe institucioneve publike në një proces bashkëpunimi që mundëson menaxhim dhe angazhim më të mirë të qytetarëve në shoqëri.
- Fokus i ripërtërirë në mediat e gazetarisë me interes publik.

Dialogu, bashkimi dhe bashkëpunimi ishin mekanizmat kryesorë të punës sonë në projekt. Rezultatet kryesore të projektit kanë treguar se presioni publik mund t’i bëjë institucionet të punojnë më mirë. Qytetarët mund të ndërmarrin veprime për çështje me interes publik kur u ofrohen informacione për efektivitetin e institucioneve. Natyrisht, duhet të kenë platformë përmes së cilës mund të informohen dhe edukohen në lidhje me atë se çfarë ndikimi kanë mbi cilësinë e jetës së tyre, vendimet që marrin dhe politikat që krijojnë institucionet. Projekti tregoi se hapat e përbashkët që rrjedhin nga formimi i koalicioneve mund të rezultojnë në ndërgjegjësimin e publikut për politikat dhe vendimet kryesore të institucioneve.

# 2

## **KOALICIONI QYTETAR PËR QEVERISJE MË TË MIRË DHE ANGAZHIM MË TË MADH TË QYTETARËVE NË SHOQËRI**




Transparenca dhe qeverisja e mirë e institucioneve publike shpesh paraqesin sfidë për demokracitë e reja ose të brishta siç është rasti me Maqedoninë e Veriut, ku debati në nivel kombëtar, me vite është fokusuar në demokratizimin, sundimin e ligjit, kohezionin social dhe cilësinë e jetës.

Ndryshimet klimatike, kujdesi për mjedisin dhe biodiversitetin, përdorimi dhe menaxhimi i burimeve natyrore janë tema të marginalizuara. Mungesa e debatit publik dhe presioni për transparencë të institucioneve për përdorimin e resurseve në fushën e mjedisit jetësor, ishin bazë për fillimin e një procesi në të cilin sektori civil do të kërkojë dhe do të hapë dialog me institucionet publike qendrore dhe lokale, për konsultime më të gjera gjatë vendimmarrjes dhe krijimit të politikave publike.

Përvoja jonë në Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) tregon se kur sektori i shoqërisë civile vepron së bashku për çështje me interes publik përmes një procesi transparent, duke informuar rregullisht publikun, mund të arrihen rezultate të mira.



# Aleanca “Kthjellohu”



E formuam Aleancën për avokim dhe lobim “Kthjellohu” të promovojmë dhe avokojmë për përdorimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe për mbikëqyrje efektive mbi përdorimin e pakontrolluar të burimeve natyrore. Filluam me 21 organizata të shoqërisë civile dhe dy iniciativa qytetare ndërsa më vonë Aleanca u shndërrua në një rrjet prej 84 partnerësh, duke përfshirë 41 të sektorit të shoqërisë civile, 36 media, katër fakultete dhe tre institucione publike. Organizatat që janë bërë pjesë e Aleancës kanë përvojë pune në tema të ndryshme, si mjedisi jetësor, të rinjtë, çështjet gjinore, sundimi i së drejtës, ekonomia dhe politika evropiane.

Për nevojat e fushatës “Kthjellohu”, si tema me interes publik kemi zgjedhur përdorimin e qëndrueshme dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, duke u nisur nga arsyet si më poshtë:

● Të dyja temat janë identifikuar si interes publik në politikat dhe legjislacionin kombëtar (Ligji për mbrojtjen e mjedisit jetësor, Ligji për ujërat).

● Përveç ndikimit mbi mjedisin jetësor, ato ndikojnë edhe mbi shëndetin publik, që është një tjetër temë me interes publik në nivel kombëtar.

● “Përdorimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e burimeve natyrore i referohet “të mirës së përbashkët publike”, mirëqenies së përgjithshme dhe sigurisë dhe mirëqenies së të gjithë personave në komunitet” - përkufizimi i Rrjetit për Gazetari Etike të Mbretërisë së Bashkuar, që u përdor në Projektin “Lidhi pikat”.

Përvoja e Aleancës ka treguar se kur organizatat e shoqërisë civile dhe mediat bashkojnë forcat për të punuar së bashku për një çështje të caktuar, rezultatet janë më të mëdha. Kjo mënyrë e punës së projekt është kthyer në praktikë jo vetëm për çështjet që ishin pjesë e fushatës, por organizatat e shoqërisë civile kërkuar dhe kanë marrë mbështetje reciproke edhe për çështje jashtë temave të fushatës, gjë që tregon se është krijuar besim, se Aleanca ka fituar integritet.

Fushata për avokim dhe lobim “Kthjellohu” filloi në dhjetor 2020. Pas përfundimit të trajnimeve për avokim dhe lobim, e krijuam Aleancën dhe identifikua temat kryesore. Menjëherë pas promovimit, fushatës iu bashkuan më shumë se 60 persona, përfaqësues të institucioneve shtetërore, mediave, akademisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Presidenti i shtetit, ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe zëvendësi i tij, drejtorët e Entit Shtetëror për Revizion dhe Inspektoratit Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti e përkrahën fushatën, ndërsa Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike, NP “Ujësjellës-Kanalizim” – Shkup dhe Inspektorati Shtetëror për Mjedis Jetësor, iu bashkuan Aleancës. Mbështetja e ndërsjellë mundësoi komunikimin e drejtpërdrejtë me Aleancën dhe mirëkuptimin e ndërsjellë se si të vazhdohet më tutje, përkatësisht sesi institucionet publike mund të menaxhojnë më mirë burimet.

Aleanca i lidhi pikat në disa nivele përmes lidhjes së institucioneve të pushtetit qendror me atë vendor, sektorin civil, hulumtuesit, gazetarët. Për të forcuar dialogun me institucionet dhe për të ndikuar në proceset përmes të cilave ato marrin vendime dhe krijojnë politika, kemi përfshirë organizata që merren me çështje mjedisore dhe kanë ekspertizë për mjedis jetësor, çështje juridike, ekonomi. Për shkak të ndikimit më të gjerë në ndërgjegjësimin e publikut, kemi përfshirë organizata që punojnë në fusha të tjera, si rinia, barazia gjinore, çështjet evropiane, të drejtat e njeriut.



## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

**Liljana Popovska,**

Instituti i Gjelbër. Rrjeti i çmuar i shumë organizatave që rezultoi me rezultate të mira

Besimi mes organizatave të shoqërisë civile u rrit, u njohëm më mirë. Takuam organizata dhe njerëz që janë të përkushtuar për të punuar në çështje të caktuara dhe u krijuan grupe ekspertësh që do të mund të punojnë në të ardhmen. Duhet të sigurohet qëndrueshmëria e rrjeteve të tilla, të cilat janë shumë-shtresore dhe shumë-sektoriale, sepse këtu u përfshinë arsimiti i lartë, institucionet shkencore, shtetërore dhe lokale dhe u mobilizuan shumë gazetarë. E gjithë kjo së bashku me organizatat e shoqërisë civile është një thesar në këtë betejë për mjedisin jetësor, që vërtet kërkon angazhim serioz.

**Martin Pushevski,**

RTVM: Rrjeti është vendosur mirë, duhet të vazhdojë

Aleanca është një hap drejt një mjedisi jetësor më të pastër. U mundësua promovim i mirë mediatik dhe bashkëpunimi me ISK-në ishte i shkëlqyer. Mendoj se mund të vazhdohet, të ushtrohet presion për politika dhe zgjidhje më të mira ndërsa rrjeti është i vendosur mirë.



# Разбистри сè!

## la dolëm të angazhohemi në dialog me institucionet

Komunikimi ndërmjet anëtarëve të Aleancës dhe lidhjes joformale horizontale kanë rezultuar të jenë një mekanizëm efektiv për ndikim mbi politikatat.


Aleanca “Kthjellohu” arriti të angazhohet në dialog me institucionet në hartimin e ligjeve dhe krijimin e politikave, siç ishte rasti me Ligjin për ujërat dhe Ligjin për lëndë të para minerale. Në procedurën për miratimin e Ligjit për ujërat, organizatat e shoqërisë civile ishin përfshirë që nga fillimi në konsultimet me institucionet kompetente dhe pas pranimit të propozimeve për ndryshime, draft- ligji është publikuar në ENER, pas kësaj vijoi debat publik. Me hapjen e dialogut, kanali i komunikimit me kreatorët e politikave mundësoi përfshirjen e komunitetit akademik, ekspertëve dhe sektorit të shoqërisë civile në hartimin e ligjeve.

Qasja e organizuar dhe kohezive e organizatave të ndryshme të shoqërisë civil, ndaj një teme të përbashkët siç është mjedisi jetësor ka çuar në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet organizatave në nivel qendror dhe lokal dhe në profilizimin e disa prej organizatave me ekspertizën e ndryshme që zotërojnë. Kjo ishte veçanërisht e dobishme për organizatat më të vogla, ose për ato që operojnë në nivel lokal.

Përveç komunitetit akademik dhe shoqërisë civile, partnerë në Aleancës ishin edhe mediat, të cilat bashkëpunuan ngushtë me anëtarët e tjerë të Aleancës në hulumtime dhe raportime për temat. Në këtë mënyrë ata u bënë faktor në shërbim të mbrojtjes së interesit publik dhe fituan besimin e publikut.

Aleanca “Kthjellohu” funksionoi si një rrjet informal ndërsa ne në ISK ishim përgjegjës për planifikimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e fushatës. Aktivitetet e partnerëve përfshinin një gamë të gjerë, nga mbështetja e iniciativave qytetare deri te drejtimi i një komponenti specifik të fushatës.

Në bashkëpunim me disa ekspertë, realizuam hulumtim të detajuar mbi temat e projektit. Projekti na lejoji të shohim përfitimet e shkencës në praktikë dhe tregoi se komuniteti akademik mund të jetë pjesë e krijimit të politikave. Profesorë dhe studiues universitarë kanë kontribuar, kanë ndihmuar në matje dhe vlerësime, kanë mbështetur aktivitetet e tyre në shkencë dhe fakte, kanë paraqitur analiza dhe kanë ofruar zgjidhje. Për shembull, matjen e cilësisë së ujit në Liqenin e Dojranit, Berovës dhe Tikveshit e ka bërë Universiteti “Goce Dellçev” nga Shtipi, me udhëzime dhe rekomandime. Ekspertët kanë kontribuar gjithashtu në mënyrën se si mund të rregullohet menaxhimi i burimeve natyrore.



## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

**Stefan Ristovski,**

Instituti për Politika Evropiane (EPI):  
Rrjetëzimi me organizata të tjera ka një  
vlerë të veçantë

Do t'i kushtonim vëmendje mobilizimit të shpejtë të organizatave joqeveritare dhe individëve për reagime të përbashkëta ndaj politikave të qeverisë dhe institucioneve në proceset e vendimmarrjes. Temat e trajtuara nga aleanca "Kthjellohu" janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe kjo platformë dëshmoi se ka kapacitet të punojë në këto çështje.

**Mimoza Mustafai,**

Press Online: Fushata ka rezultuar me  
ndryshim të ndërgjegjësimit mjedisor

Fushata ka bërë ndryshim në ndërgjegjësimin mjedisor të qytetarëve ndërsa autoritetet lokale do të angazhohen më seriozisht me mbrojtjen e të mirave ekologjike dhe të mirave publike. Do të përmirësohet mbrojtja e burimeve ujore gjithashtu do të investohet edhe në rrjetet terciare dhe dytësore të ujit. Lumenjtë, gjithashtu do të jenë prioritet për autoritetet lokale, do të ketë më shumë parqe dhe mjedis jetësor të gjelbër.



## E detyruam qeverinë të tërheqë ligjin

Qasja joformale e Aleancës u dëshmuar se është shumë efektive. Kur partnerëve u duhej të reasonin shpejt ndaj ngjarjeve të jashtme, kishte bashkëpunim dhe fleksibilitet të konsiderueshëm brenda Aleancës. Për shembull, në fillim të fushatës, Aleanca zbuloi se në Kuvend është parashtruar një propozim-ligj potencialisht i dëmshëm për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndë të para minerale. Kështu, Aleanca arriti të organizohej shpejt, të kërkonte nga deputetët, partitë politike dhe Qeveria, ndërprerjen e procedurës. Aleanca bëri publike dobësitë në draft - ligjin, duke shprehur qartë qëndrimin e saj dhe kërkesat drejtuar të gjitha palëve. Ministria e Ekonomisë e tërhoqi ligjin për përpunim të mëtejshëm dhe ftoi Aleancën të marrë pjesë në proces, duke pranuar disa nga komentet dhe sugjerimet e saj.

Fleksibiliteti i punës së Aleancës dhe mjedisi i këndshëm i punës në të cilin punonin partnerët, mundësoi të hapen edhe çështje jashtë temave të fushatës. Shembull për këtë janë aktivitetet për mbrojtjen e pasurisë natyrore Vodno, ose statusin e Rajonit të Ohrit si trashëgimi natyrore dhe kulturore botërore nën kujdesin e UNESCO-s. Partnerët u angazhuan në një debat mbi strategjitë më të mira për këto çështje, ose dhanë mbështetje për eko-aktivistët. Për një debat të suksesshëm të organizatave që punojnë në të njëjtën fushë tematike është veçanërisht e dobishme kur ka kushte relativisht të relaksuara për diskutim. Në një atmosferë të tillë, përfaqësuesit e organizatave shkëmbejnë informalisht informacione, mbështesin njëri-tjetrin dhe vijnë në zgjidhje për problemet e përbashkëta. Kjo qasje mund të jetë e dobishme edhe për përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm, të cilët në këtë mënyrë mund të kenë një këndvështrim të ndryshëm për temat, por edhe të fitojnë besim të ndërsjellë.

## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

**Bojan Trpevski,**

Shoqata Maqedonase e Juristëve të

Rinj: Aleanca kontribuoi pozitivisht

në përmirësimin e ligjeve

Me aktivitetet avokuese përmes mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, përfshirjen në ndryshimin e ligjeve (Ligji për ujërat, Ligji për lëndë të para minerale, Ligji për inspektimin në mjedisin jetësor) dhe mbështetjen e institucioneve në aspektin e transparencës dhe efikasitetit, fushata ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e situatës. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi dhe komunikimi i krijuar ndërmjet organizatave të shoqërisë civile ka rezultuar edhe me themelimin e Këshillit të Inspektimit Civil, si një formë e re e veprimit të organizuar dhe punës së organizatave civile në fushën e mjedisit jetësor. Mënyra e komunikimit dhe e punës së përbashkët e vendosur në fushatë është një bazë e mirë për ndikim të mëtejshëm pozitiv mbi politikat.





## Разбистри се!

Онлајн ресурси

### Kemi zhvilluar online burime për avokim dhe lobim për organizatat civile

Në ISK kemi punuar me sektorin civil dhe me mediat për përforcimin e kapaciteteve përmes trajnimeve për avokim dhe lobim. Kemi ofruar burime dhe mbështetje për partnerët, si dhe mjetet e nevojshme që të punojnë për mbrojtjen e interesit publik dhe vlerësimin e punës së institucioneve, në mënyrë kritike.

Për t'i mundësuar sektorit të shoqërisë civile që të vazhdojë me analizat kritike pas përfundimit të projektit, kemi përgatitur dhe publikuar online- resurse për organizatat e shoqërisë civile për avokim dhe lobim. Resurset mund të përdoren nga shoqatat e qytetarëve dhe organizatat e tjera që punojnë në projekte të ngjashme apo realizojnë aktivitete të ngjashme dhe do të ndihmojnë në krijimin e koalicioneve të reja, të cilat do të përfitojnë nga ky projekt.

Disa nga anëtarët e Aleancës janë organizata të vogla, kështu që partneriteti ishte i dobishëm për ta për transferim të përvojave, për udhëzime në procesin dhe mbështetje me materiale promovuese, si dhe marrëdhënie me median. Çdo partner në Aleancë ishte i barabartë, mund të dëgjohej zëri i organizatave të mëdha dhe të vogla. Të gjithë ishin të përfshirë në mënyrë të barabartë në procesin e konsultimeve për zgjidhjet ligjore, promovimin, fushatat në mediate, avokim dhe lobim. Mbështetja iu përshtat çdo organizate sipas nevojave të saj, nga marrëdhëniet me mediat deri tek mbështetja gjatë organizimit të eventeve, si dhe formulimi i mesazheve kryesore dhe udhëzimeve të përgjithshme për marrëdhënie me publikun.

Aleanca ka kontribuar në ndryshimet kryesore në shoqëri përmes punës së saj. Tregoi se bashkimi i sektorit të shoqërisë civile, komunitetit akademik dhe mediave mund të jetë funksional dhe efektiv për hapjen e dialogut me institucionet publike për mbrojtjen e interesit publik. Dëshmoi se është e rëndësishme që sektori i shoqërisë civile të jetë aktiv dhe të kërkojë përgjigje nga institucionet qeveritare, të ndikojë në kulturën institucionale për të arritur transparencë dhe llogaridhënie më të mirë.





## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

Stefani Spirovka,

Forumi Arsimor Rinor (FAR): Aleanca duhet të vazhdojë patjetër, problemet mjedisore ngelin

Në publik u hapën çështje të cilat deri atëherë nuk ishin pasqyruar publikisht ndërsa vlera e shtuar është se një numër i madh i të rinjve u përfshinë aktivisht në krijimin e përmbytjes në fushatë, nga të cilat mund të presim veprimin e tyre aktiv në lidhje me këtë temë edhe në të ardhmen. Aleanca duhet të vazhdojë patjetër. Temat e fushatës nuk janë diçka që ndalet këtu, problemet që trajton fushata mbeten, ndoshta vetëm në formë dhe intensitet të ndryshëm.

## Si iu përgjigjën fushatës institucionet qeveritare

- Në partneritet me Inspektoratin Shtetëror për Mjedis Jetësor (ISHMJ), kemi krijuar një mjet që u mundëson qytetarëve të përdorin mediat sociale, faqen e internetit ose e-mailin e Inspektoratit për të raportuar ndotjen. Në këtë mënyrë përmirësohet procesi i raportimit dhe reagimi i inspektorëve, sepse tani ata kanë mundësi të pranojnë të gjitha raportimet në një vend dhe të planifikojnë inspektimet në mënyrë më efikase.
- Në bashkëpunim me ISHMJ-në, kemi krijuar Këshillin Inspektues Civil (KIC), i cili bashkon tridhjetë organizata të shoqërisë civile dhe institucione të arsimit të lartë të angazhuara për mbrojtjen e mjedisit. Këshilli mundëson bashkëpunim më efikas të sektorit civil dhe qytetarëve me Inspektoratin, si institucion qendror për mbikëqyrje dhe sanksionim të ndotjes dhe shkatërrimit të mjedisit jetësor.



○ KIC dhe Aleanca “Kthjellohu” paraqitën amendamente për propozim - ligjin për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor, i cili është në procedurë parlamentare. Amendamentet i referohen një zgjidhjeje konsistente për koordinimin e inspektorëve shtetërorë dhe lokal, mbikëqyrje funksionale nga ISHMJ-ja mbi inspektorët lokal, një procesi më thelbësor të planifikimit të inspektimeve, disponueshmërisë së inspektorëve pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës, pajisjes së inspektorëve dhe forcimit të transparencës. Paraprakisht, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) ka pranuar disa nga vërejtjet e KIC-së në Propozim - ligjin për inspektim në mjedisin jetësor në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien e ISHMJ-së, siç për shembull, të mbajë bazën e të dhënave për mbikëqyrje inspektuese dhe regjistër të subjekteve.

○ ISHMJ ka zhvilluar platformë digjitale për regjistër elektronik të subjekteve të mbikëqyrjes inspektuese në nivel shtetëror dhe lokal, si dhe bazë të të dhënave dhe gjenerimin e raporteve nga mbikëqyrjet inspektuese, të cilat do të jenë të qasshme për publikun në faqen e internetit të Inspektoratit.

○ Aleanca “Kthjellohu”! vendosi bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë për Ligjin për lëndë të para minerale, për të cilin për herë të parë pati konsultime më të gjera me shoqërinë civile, industrinë minerare dhe deputetët në Kuvend. Propozim - ligji për lëndët e para minerale është sërish në procedurë parlamentare pasi u tërhoq dhe u rishikua nën presionin publik të Aleancës “Kthjellohu”. Nga analiza e propozimit të ri rezultoi se propozim - ligji është përmirësuar seriozisht dhe janë pranuar shumica e propozimeve të Aleancës, , e cila ka marrë pjesë në disa takime konsultative në Ministrinë e Ekonomisë gjatë përgatitjes së


tekstit ligjor. Propozim - ligji specifikon procedurat për marrjen dhe anulimin e koncesioneve, ndërkaq shtohen detyrimet e koncesionarëve ndaj shtetit. Megjithatë, ende mungojnë disa kërkesa të Aleancës për transparencë më të madhe gjatë dhënies së koncesioneve për banorët lokal, respektim më të madh të parametrave ekologjik gjatë nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe liqenet dhe rregullim më i mirë i mbetjeve të zgjyrës si vende potencialisht më të rrezikshme në komplekset minerare. Për këtë arsye Aleanca përgatiti propozim-amendamentet të cilat ia dorëzoi Kuvendit dhe deputetëve.

○ Ndryshimet në Ligjin për ujërat hapin mundësi më të mëdha për mbrojtjen e burimeve ujore pasi MMJPH përfshiu organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë të Aleancës “Kthjellohu” në fazën më të hershme të hartimit të ligjit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme publiku të përfshihet në dhënien e koncesioneve për përdorimin e ujit, të rregullohet më saktë ndërtimi dhe funksionimi i hidrocentraleve të vogla ndërsa rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të liqeneve do të ketë përparësi para nxjerrjes dhe shitjes së rërës dhe zhavorrit. Gjithashtu, janë rreptësuar kushtet për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujërave, është forcuar kontrolli gjatë shkarkimit të ujërave të zeza, veçanërisht në ujërat nëntokësore dhe është forcuar mbikëqyrja inspektuese.

○ Është zhvilluar platformë digjitale për monitorim nga Drejtoria Hidrometeorologjike për cilësinë e ujërave sipërfaqësore. Platforma digjitale për monitorim ka përmirësuar sistemin e mbledhjes së të dhënave dhe vlerësimet dhe shërbimet e monitorimit janë të qasshme për publikun. Kjo mundëson krijimin e një pasqyre të integruar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave të mbledhura nëpërmjet matjeve të ujit dhe programeve efektive të monitorimit.



MMJPH ka përgatitur platformë digjitale për Librin e Ujit, e cila do të jetë e qasshme për publikun. Libri i ujit përmban një bazë të dhënash në të cilën do të ruhen dhe ruhen të dhënat e nevojshme për menaxhim efikas me ujërat në vend, si dhe të dhëna për subjektet fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja që kanë marrë leje apo koncesione për shfrytëzimin e ujit dhe burimeve ujore.



## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

Katerina Mihailov Veljanovska,

NP Ujësjellës dhe Kanalizim - Shkup:

Fushata ofroi zgjidhje për problemet reale

Fushata e realizuar “Kthjellohu” është e suksesshme, duke pasur parasysh temat, çështjet dhe problemet që u prezantuan publikisht ndërsa gjatë përpunimit të tyre për një pjesë u ofruan edhe zgjidhje përkatëse në lidhje me rrënjët e problemeve, përkatësisht ndryshimet ligjore. Ndryshimet e pritshme, si rezultat i fushatës, janë ndërmarrja e hapave dhe masave reale për bashkëpunim ndërmjet të gjitha institucioneve kompetente për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve që u ngritën si të tilla në fushatë dhe ndërgjegjësimin e publikut.



# 3

## GAZETARIA ME INTERES PUBLIK, SËRISH NË FOKUSIN E MEDIAVE

Mediat në Maqedoninë e Veriut kryesisht raportojnë për tema aktuale, ndërsa rrallë ka shembuj të gazetarisë hulumtuese dhe artikuj me interes publik. Për dallim nga kjo, përmbajtjet mediatike të përgatitura gjatë projektit “Lidhi Pikat” i mundësoi medias të kalonte në gazetari me interes publik, raportim me cilësi më të mirë, në një qasje editoriale që u jep më shumë hapësirë çështjeve me interes publik në historitë gazetareske.

Në projektin “Lidhi Pikat”, mediat ishin partnere dhe mundën të mbështesnin proceset nga brenda. Përmbajtjet mediatike mbuluan tema specifike, prezantuan çështje të reja, njerëz dhe përmbajtje të reja. Gjatë punës për tema specifike, gazetarët patën mbështetje të plotë. Ata mund të përdornin një shumëllojshmëri burimesh dhe mjetesh, përmbajtje arsimore dhe profesionale, qasje të shkencëtarët, ekspertët, bazat e të dhënave të ndryshme, por më e rëndësishmja, kishin lirinë krijuese për të modeluar artikujt e tyre pa ndikim politik ose biznes - ndikim, të nxitur vetëm nga interesi publik.

Projekti identifikoi zona me interes publik që nuk ishin raportuar më parë në media, ose ishin të margjinalizuara, si menaxhimi i burimeve ujore dhe mbikëqyrjet inspektuese gjatë përdorimit të tepërt të burimeve natyrore - ujit, pyjeve dhe lëndëve të para minerale.



Përveç prezantimit të problemeve dhe sfidave kryesore, përmbajtja mediatike u fokusua në gjetjen e zgjidhjeve. Ato përkonin me qëllimet e fushatës - ngritjen e vetëdijes publike për mjedisin, rritjen e ndikimit të qytetarëve në krijimin apo ndryshimin e politikave ekzistuese, si dhe mundësimin e dialogut më të mirë me institucionet publike në procesin e miratimit të masave dhe politikave.

Mediat e reja, veçanërisht hulumtuesit e rinj, eko-aktivistët, eko-ambasadorët, ekspertët, njerëzit që paraqitën zgjidhje të mundshme, të dhëna dhe argumente të besueshme, morën hapësirë adekuate në përmbajtjet mediatike. Koalicioni ambicioz për avokim ka arritur të bëjë mjedisin jetësor, menaxhimin me burimet natyrore dhe urbanizmin dhe planifikimin, të jenë temë me interes publik për një numër të mediave në Maqedoninë e Veriut.



## Çfarë thonë partnerët e Aleancës


**Katerina Topalova,**

**RTVM: Servisi publik  
është i detyruar të hapë  
tema të nxehta**

Aktualizimi mediatik i problemeve të rënda në lidhje me lumenjtë tanë do të thotë sukses i madh sepse ndikon në edukimin, ndërgjegjësimin dhe presionin ndaj institucioneve. Fushata ka rezultuar me mbulim më të madh të çështjeve të ngjashme në media. Shërbimi publik është i detyruar të hapë tema të tilla të problematike.





## Platformat e mediave digjitale të Institutit për Studime të Komunikimit në projektin “Lidhi pikat”





**DOMA** është platformë digjitale, fokusi kryesor i së cilës është biodiversiteti, rreziqet natyrore, qëndrueshmëria e ekosistemit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe investimi në mjedisin jetësor. Në platformë bashkëpunojmë me një rrjet shkencëtarësh, përfaqësues të komunitetit akademik, medias dhe institucioneve publike për të përgatitur dhe publikuar përmbajtje mediatike që përmban të dhëna të verifikuara.

DOMA i “lidh pikat” mes këndvështrimit shkencor, përgjegjësisë institucionale dhe mbrojtjes së interesit publik. Institucionet nga të cilat DOMA kërkon përgjigje marrin gjithashtu një platformë ku mund të vendosin pikëpamjet e tyre. DOMA në këtë mënyrë kontribuon që qytetarët të jenë më të informuar dhe i inkurajon të angazhohen aktivisht në mbrojtjen e mjedisit.

Studiuesit e rinj në fushën e shkencave natyrore janë shpesh pjesë e platformës që i motivon të punojnë në projekte të reja kërkimore. DOMA u jep hapësirë eko-ambasadorëve në nivel kombëtar dhe rajonal, të cilët me punë të palodhshme kanë arritur zgjidhje të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit. Përveç operimit në nivel kombëtar, DOMA gjithashtu punon me partnerë në rajon me të cilët eksploron burimet natyrore rajonale, rreziqet dhe kërcënimet mjedisore.






**ResPublica** (ResPublica) është platformë që paraqet pikëpamje të ndryshme të pavarura për çështje me interes publik nga profesorë, analistë, studiues, gazetarë, aktivistë civilë, ekspertë të fushave të ndryshme, nëpunës publikë dhe studentë. ResPublika u mundëson qytetarëve të informohen nga burime të besueshme për tema të ndryshme dhe të marrin vendime të informuara. ResPublika është burim falas dhe të gjithë qytetarët lirisht mund ta lexojnë, ta shpërndajnë ose ri publikojnë përmbajtjen në përputhje me standardet profesionale të politikës së komenteve.

Mediat përdorin gjithashtu përmbajtjen e publikuar në këtë platformë, veçanërisht sepse ResPublika plotëson boshllëkun që ekziston midis mediave dhe nevojës së tyre për një burim të vazhdueshëm dhe të besueshëm informacioni që është i nevojshëm për analiza të thelluara në lidhje me çështjet me interes publik.






**Vetëm pyet** është platformë digjitale ISK përmes së cilës u përgjigjemi pyetjeve të qytetarëve, hulumtojmë dhe informojmë për tema me interes publik. Platforma jonë njihet si një urë lidhëse mes qytetarëve dhe institucioneve sepse mundëson thyerjen e mostransparencës së sektorit publik. Përmes mjeteve interaktive të kësaj internet faqe dhe mediave sociale, qytetarët mund të bëjnë pyetje për problemet që i mendojnë dhe të marrin përgjigjet përkatëse nga institucionet dhe sektori i shoqërisë civile.

Njëkohësisht, “Vetëm pyet” përmes storjeve investigative gazetareske, analizave, videove, fotostorjeve dhe intervistave informon për tema të rëndësishme sociale me interes publik, të harruara nga mediat tradicionale. Në këtë mënyrë e ndërgjegjësojmë opinionin maqedonas për problemet esenciale të përditshme të cilat e dëmtojnë cilësinë e jetës dhe kërkojmë aksion nga autoritetet për zgjidhjen e tyre.

“Vetëm pyet” ofron edhe burime edukative që u mundësojnë qytetarëve të gjinden më lehtë nëpër labirintet administrative dhe të kuptojnë problemet sociale. Në këtë mënyrë “Vetëm pyet” krijon qytetari aktive, e cila do të kërkojë transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet dhe bashkë me to shoqëria civile dhe mediat do të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve sociale.



## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

**Nazim Rashidi,**

**ALSAT-M: Kemi punuar  
tema, të cilat nuk i kishim  
menduar më parë**

Fushata ndihmoi për t'u fokusuar në temat. Për shembull, kishte emisione televizive që nuk do të bëheshin më parë, si për shembull për ndotjen e ujërave që përdoret për ujitje. U mundësua informim më i madh për temën, i cili mungonte më parë. Është e dobishme që mediat ishin të përfshira që në fillim të krijimit të fushatës. Aleanca ishte e suksesshme sepse hapi mundësi për përgatitjen e temave, për të cilat nuk kishim menduar më parë dhe na mundësoi të arrinim tek më shumë ekspertë dhe burime informacioni.

# 4

## TEMA TË PËRBASHKËTA QË SHQETËSOJNË QYTETARËT E RAJONIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Hulumtimi për nevojat e projektit “Lidhi pikat” përcaktoi se qeverisja e mirë dhe transparenca e institucioneve publike janë tema me interes të përbashkët në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto tema janë bërë edhe më të rëndësishme pasi në rajon u përballëm bashkërisht me pasojat katastrofike të pandemisë Kovid-19. Ekipi i ResPublika e pa potencialin e temave të përbashkëta për të filluar një debat që lejoi audiencën në rajon të shohë perspektiva të ndryshme.

ResPublika publikoi disa blogje, vlogje dhe podkaste, të cilat shpesh i përkthenim në gjuhën shqipe, boshnjakisht, maqedonisht, serbisht, gjuhën malazeze dhe anglisht. Përmbajtjet mediatike dominohen nga tema të përbashkëta, siç janë mënyra se si rajoni përballlet me krizën Kovid-19, korrupsioni, transparenca e masave të qeverisë, liria e medias... Gazetarë, ekspertë, njerëz me ndikim, përfaqësues të sektorit civil dhe institucioneve shtetërore nga shumë vende - të gjithë përdorën përvojën e tyre për të ndarë pikëpamjet analitike mbi çështjet aktuale. Ky është avantazhi ynë kryesor - të arrijmë në vende dhe audiencë të ndryshme me përmbajtjet tona. U prezantuan një gamë e gjerë e pikëpamjeve, shifra të sakta dhe të dhëna zyrtare, të cilat kontribuuan në besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike. Ekipi për mbështetje teknike përgatiti paraqitje të shkëlqyera vizuale të përmbajtjeve mediatike, të cilat ndihmuan në prezantimin e temave dhe çështjeve komplekse në një mënyrë që të ishte lehtësisht e arritshme për audiencën.



Puna e projektit tregoi se mund të ketë bashkëpunim cilësor me organizata të tjera nga rajoni. ResPublika ka 44 partnerë nga sektori i shoqërisë civile, internet medias, radios, si dhe platforma të politikave të blogimit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kosova, Sllovakia, Sllovenia, Serbia, Mali i Zi dhe Kroacia. Avantazhi i bashkëpunimit është ngritja e vetëdijes për tema të caktuara me rëndësi rajonale dhe mundësia që audiencia jonë të ndjekë këndvështrime dhe pikëpamje të ndryshme. Njerëzit duhet të dinë se çfarë po ndodh në Ballkanin Perëndimor dhe në rajon më gjerë.

ResPublika ofroi një platformë për pikëpamjet në shoqëri që nuk ishin të përfaqësuara në media të tjera. Këto pikëpamje nuk ishin prezantuan shpesh, veçanërisht në mediat tradicionale. Zgjerimi i përmbajtjeve mediatike me autorë nga rajoni ka treguar se ka interes dhe dëshirë për bashkëpunim në Ballkanin Perëndimor. Mediat duhet të ndajnë përvojat rajonale. Mund të mos jetë diçka e re, por është më se e nevojshme.



Ajo që mund të bëhet në të ardhmen është të identifikohen temat më të rëndësishme që prekin rajonin dhe të tërheqin vëmendjen e audiencës, të hulumtohen në mënyrë profesionale dhe t'i vendosim ato në një kontekst lokal gjatë raportimit. ISK ka përvojë me projekte rajonale në të kaluarën. E përdorëm përvojën, për të gjetur partnerë nga rajoni për këtë projekt. Krijimi i lidhjeve ndërmjet faktorëve kryesorë hap derën për partneritete të ardhshme për tema të ndryshme me interes të përbashkët, veçanërisht në kontekstin e integritimit në BE dhe NATO.

## Çfarë thonë partnerët e Aleancës

Jugosllava Polenak,


Free Press: Publiku tani ka një pasqyrë më të qartë për problemet mjedisore

U hapën një sërë çështjesh të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së ujërave, dobësi në zbatimin e ligjeve, raport i papërgjegjshëm i institucioneve dhe u ofruan zgjidhje të mundshme. Publiku tashmë ka një pasqyrë më të qartë për situatën dhe problemet. Ndryshime të dëshirueshme do të ishin riorganizimi në institucionet kompetente, miratimi dhe ndryshimi i ligjeve në drejtim të ndryshimeve të dëshiruara, miratimi dhe ndryshimi i akteve nënligjore që kanë munguar ose janë modeluar në mënyrë që të mbrojnë interesa të caktuara, jo të mbrojnë mjedisin jetësor.



## 5 PJESËMARRJA E BARABARTË E GRAVE

Barazia dhe përfshirja janë ndër parimet kryesore që ISK i zbaton në çdo projekt. Në ISK ka një strukturë heterogjene të të punësuarve, grave dhe burrave u jepen mundësi të barabarta për punë, udhëheqje, vendimmarrje, fitim, mësim dhe zhvillim.




Barazia gjinore dhe përfshirja ishin parimet udhëheqëse të projektit “Lidhi pikat” në shumë aspekte: përfaqësimi adekuat i grave dhe burrave në pozitat menaxheriale, në ekipin e projektit, si dhe në udhëheqjen e komponentëve të ndryshëm të projektit. Gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta të jenë pjesë e Aleancës “Kthjellohu” dhe të shprehin pikëpamjet e tyre. Anëtar i Aleancës, për shembull, është një organizatë partnere që punon për çështjet gjinore. ISK u jep udhëzime bashkëpunëtorëve në krijimin e përmbajtjeve mediatike të sigurojnë mundësi të barabarta që gratë dhe burrat të shprehin pikëpamjet e tyre. Në ekipin e produksionit dhe në burimet e informacioneve ka përfaqësim të balancuar gjinor. Kur kontrollohet cilësia e përmbajtjeve mediatike, merret parasysh perspektiva gjinore, ndërsa gjatë prezantimit të zgjidhjeve dhe shembujve inspirues në mënyrë të vetëdijshme shmangen paragjykimet dhe stereotipet. Vëmendje e veçantë i kushtohet përfaqësimit të grave në përmbajtjet mediatike që janë pjesë e projektit. Evitohen stereotipet ndërsa më shumë fokus i kushtohet rolit udhëheqës që kanë ose duhet të kenë gratë në shoqëri.

Kemi prodhuar disa përmbajtje mediatike dhe intervista me gra që formojnë opinionin publik, aktiviste të shoqërisë civile, gra vendimmarrëse, mbikëqyrëse, gra në fushën e biznesit dhe novatore.

Gjithashtu, kemi bashkëpunuar me Shoqatën e Grave Afariste në organizimin e tryezave me gra nga zonat rurale, ku është paraqitur roli aktiv i grave në bujqësi dhe prodhimin e ushqimit.

Projekti tregoi se nuk ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm në mesin e institucioneve publike për rëndësinë e balancës gjinore gjatë vendimmarrjes. Hulumtimet që ishin pjesë e projektit, megjithatë, treguan se menaxhimi i burimeve natyrore dominohet nga burrat. Disa institucione mungon vetëdijesimi për rëndësinë e procesit të konsultimeve, në të cilat do të përfshihen grupet më pak të përfaqësuara ose ndikimi i masave, politikave ose vendimeve mbi këto grupe.

Projekti demonstroi nevojën për mbështetje e organizatave civile lokale që punojnë në çështjet gjinore që të kenë përfitime afatgjata. Gjithashtu tregoi se përfaqësimi i dimensionit gjinor mungon në mbulimin mediatik dhe në temat me interes publik. Publiku është i etur për informacione dhe ndërgjegjësim për çështjet gjinore. Duhet të inkurajojmë gratë, të përfshihen më shumë dhe të angazhohen në mënyrë aktive në çështje siç janë qeverisja e mirë dhe shërbime më të mira nga institucionet publike.



## Zëri i grave në projektin “Lidhni pikat”



Videostoria “Thesaret fosile të Maqedonisë”, të cilën e publikuam në DOMA, tregon depon paleontologjike të Muzeut Historik Natyror të Maqedonisë dhe vendet më të pasura paleontologjike në vend, të cilat janë harruar nga autoritetet. Historia paraqet Biljana Garevska-n, paleontologjen të vetme në Maqedoni. Ajo ndau përvojën e saj, si e vetmja grua në këtë disiplinë shkencore. Puna e Garevskes shfaqet në përmbajtje mediatike që ndoqën gjurmimin e fosileve të

rralla në fshatin Disan i Poshtëm, së bashku me një ekip kolegësh nga Bullgaria, ku ajo është e vetmja femër. Storja theksoi dy aspekte të rëndësishme - i ndihmoi mediat të krijojnë hapësirë për një fushë shkencore që rrallë merr vëmendjen e medias dhe tregoi se Maqedonia ka potencial për zona të mbrojtura. Gjithashtu i dha hapësirë mediatike të vetmes paleontologe femër në Maqedoni, duke thyer stereotipin dhe duke portretizuar një grua shkencëtare të suksesshme, temë që rrallë gjendet në mediat maqedonase. Kjo mund të jetë inkurajim për gratë, që të punojnë në shkencat natyrore.

Në një intervistë për ResPublika, profesoresha dhe aktivistja **Ana Martinoska** prezantoi pasojat e nënvlerësuara të pandemisë Kovid-19 tek gratë. Ajo prezantoi argumente se pandemia u bë ngarkesë shtesë për gratë - duke nxitur një pandemi të heshtur të përqesimit të shëndetit të tyre. Gratë kanë detyrime shtëpiake që askush nuk ua paguan, janë edhe përkëdhelëse dhe mësuese, kujdesen për shtëpinë ndërsa numri i rasteve të dhunës në familje është në rritje. Martinoska theksoi nevojën që shteti të përfshijë perspektivat e grave në vendimmarrje dhe politikëbërje.

Shkrimtarja **Ana Golejska-Dzikova** ka publikuar blog në ResPublika, duke paraqitur një tjetër dimension femëror të lënë pas dore gjatë pandemisë, balancën e të qenit autore, grua e punësuar dhe nënë gjatë pandemisë. Ajo argumenton se “kalaja” e përgjegjësive rritet gjatë pandemisë dhe se gratë, në mungesë të mbështetjes më të gjerë sociale, përdorin aftësitë e tyre vetëmbrojtëse për të përfunduar një seri të pafund përgjegjësish, duke mos pasur kohë apo hapësirë për veten e tyre.

**Ana Avramoska** nga Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave ka folur për pandeminë e padukshme të dhunës në familje, në një investim për ResPublika. Ajo theksoi se ndërsa kishte fushata gjatë pandemisë, që njerëzit të qëndronin në shtëpi, për shumë gra shtëpia nuk ishte një vend i sigurt. Një analizë e Rrjetit Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave tregoi se 60 për qind e viktimave u vranë nga partneri i tyre intim. Avramoska theksoi ndryshimet e nevojshme në Kodin penal për të përcaktuar dhe saktësuar termat “përdhunim”, “ngacmim seksual” dhe “përndjekje”, sepse dhuna ndaj grave nuk është problem privat, por social.

“Vetëm pyet” hulumtoi punën gjatë pandemisë së punëtorëve të tekstilit në konfeksionet në Shtip, të cilat janë kryesisht gra, dhe betejën e tyre për të fituar para për familjen, duke punuar në një sektor më të goditur nga pandemia.

Dekanja e Fakultetit të Edukatës fizike, sportit dhe shëndetësisë, **Lençe Aleksovsk-Veliçkovska**, në një investim për ResPublika ka theksuar nevojën e rritjes së përfaqësimit të grave në sport, në vend. Ajo theksoi se në vitin 2004 në të gjitha organizimet sportive kishte prezencë prej 2 përqind të grave, sot është rritur në 8 përqind, që është ende një shifër shkatërruese. Aleksovsk-Veliçkovska shton se nëse çdo njëzet vjet pritet që prania e femrës të rritet për 5 apo 10 përqind, atëherë nuk do të ketë përparim në sport, dhe për të pasur më shumë gra në sport dhe organizime sportive duhet më shumë investime.

## Fushata “Kthjellohu” paraqiti disa gra me përvojë specifike në fushat ku gratë janë të nën përfaqësuara



**Danka Ilijeva**, e cila posedon një fermë në fshatin Zrnovci në Maqedoninë lindore, ishte pjesë e storjeve mediatike të përgatitura në fushatën për menaxhimin me ujërat. Ajo sugjeroi nevojën për një hidro-sistem funksional që të përmirësohen mundësitë për përparim në blegtori dhe prodhimin e ushqimit.



**Zhivka Gjurçinovska**, një sipërmarrëse në bujqësi nga fshati Tumçevishtë i Gostivarit, ndau pikëpamjet e saj për mungesën e një sistemi të furnizimit me ujë dhe menaxhimit efikas të ujit, i cili ndikon në bujqësi, prodhimin e ushqimit dhe cilësinë e jetës. Gjurçinovska foli për nevojën e shfrytëzimit efikas të ujit që duhet të monitorojë prodhimin e kulturave bujqësore.



**Vidojka Gerasimovska**, një fermere në moshë, dha retrospektivë se si ka qenë bujqësia dikur dhe si është tani. Përvoja e saj ishte e dobishme për të krijuar një pamje të vazhdimësisë së bujqësisë në vend.



**Suzana Dimitrievska** nga fshati Mustafino në Maqedoninë lindore tani më 15 vjet prodhon ushqim organik si prodhuese dhe sipërmarrëse autodidakte e prodhimit të ushqimit. Duke qenë se uji është burimi i saj kryesor, Suzana thekson se uji, së bashku me diellin dhe erën, është i rëndësishëm për bujqësinë dhe për këtë arsye uji duhet mbajtur i pastër dhe të menaxhohet mirë. Sipas Dimitrievska, fermerët duhet të trajnohen për dinamikën dhe mënyrën e përdorimit të ujit për ujitje, sepse sasi të ndryshme të ujit ndikojnë në cilësinë e ushqimit.



**Sonja Angelevska-Koleva** nga Negotina është inspektore e elektroteknikës dhe kryen mbikëqyrje mbi cilësinë në termocentrale dhe në prodhimin e energjisë elektrike. Ky është një profesion i rrallë për gratë, ndërsa ajo punon në ndërmarrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e ujit, tokës dhe ajrit. Duke pasur parasysh punën e saj aktive si përfaqësuese për një mjedis të pastër, foli për nevojën e zgjidhjeve sistematike për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Duke punuar si mentore e studentëve të inxhinierisë elektrike, ajo gjithashtu inkurajoi të rinjtë që të zhvillojnë interes për punën shkencore.



# 6


## HISTORI SUKSESI: SA NA KUSHTOJNË HIDROCENTRALET E VOGLA?

Ndërtimi dhe funksionimi i hidrocentraleve të vogla në Maqedoninë e Veriut është një çështje me interes publik që nuk ishte e përfaqësuar në diskursin publik. Ekipi i DOMA-s vendosi të hulumtojë temën që mbahej sekret, duket komplekse ndërsa ka një ndikim të madh në jetën e përditshme të qytetarëve.

Maqedonia dhe vendet e rajonit përballen me sfida kur bëhet fjalë për marrjen e energjisë pa shkatërruar natyrën dhe hidrocentralet e vogla duken si një zgjidhje e thjeshtë dhe e lirë. Hulumtimet e kryera nga DOMA kanë treguar se hidrocentralet e vogla kërkojnë investime të vogla, por ato përdorin në mënyrë të konsiderueshme ujën e lumenjve dhe ndikojnë në biodiversitetin brenda dhe rreth pellgjeve lumore. Ato prodhojnë një sasi të konsiderueshme energjie dhe marrin subvencione të konsiderueshme nga qeveria, që nuk do të thotë se janë ekonomikisht të qëndrueshme.

Mediat rrallë ose kurrë nuk raportuan për këtë temë. Qeveria dhe shërbimet publike nuk dhanë të dhëna për hidrocentralet e vogla.

Ekipi i DOMA-s bashkëpunoi me gazetarë, ekspertë, aktivistë të shoqërisë civile në hulumtimin për këtë temë, publikuam të dhëna me të cilat informuam dhe edukuam publikun për ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentraleve. Folëm edhe me pronarët e hidrocentraleve të vogla për të pasur një pasqyrë të plotë të temës. Midis shumicës së përmbajtjeve mediatike, prodhuam dokumentarë, video të shkurtra dhe artikuj që eksploronin ndërtimin, funksionimin dhe mbështetjen



e qeverisë për hidrocentralet e vogla. Gjithashtu, për herë të parë në platformën DOMA është bërë një hartë digjitale që tregon të gjitha hidrocentralet e vogla në Maqedoni – vendndodhjen e tyre gjeografike, të dhënat e pronësisë, periudhën e licencës, vëllimin e prodhimit dhe subvencionet në vitin 2020.

Kemi arritur të marrim dhe publikojmë të dhënat zyrtare për mbështetjen e qeverisë për pronarët e hidrocentraleve të vogla. Të dhënat treguan një rritje të vazhdueshme të numrit të hidrocentraleve të vogla që subvencionohen në Maqedoninë e Veriut, si rezultat i politikës së qeverisë që nga viti 2010, e cila i lejon operatorit shtetëror të tregut të energjisë MEPSO të blejë energji nga prodhuesit preferencialë me një çmim të rregulluar. Çmimin e paguajnë në fund taksapaguesit, qytetarët, të cilët janë konsumatorë të energjisë elektrike. Pavarësisht se qeveria blen energji elektrike nga prodhues të tjerë si parqet e erës, impiantet fotovoltaike dhe impiantet e biogazit, pagesat më të larta janë për energjinë elektrike me tarifa të preferuara për hidrocentralet e vogla.

## Hulumtimi i temës së hidrocentraleve të vogla na ka ndihmuar të arrijmë mësimet si më poshtë:

### Imazhi i plotë i situatës, i rrënon mitet

Përmbajtja mediatike përfshinte pikëpamjet e eko-aktivistëve, ekspertëve dhe pronarëve të hidrocentraleve të vogla. Me këtë ne ndihmuam publikun që të ketë një pasqyrë të qartë të parave të shpenzuara nga shteti për hidrocentralet e vogla, kthimin e investimit, si dhe efektin që kanë hidrocentralet e vogla mbi mjedisin jetësor.

Ekipi i medias shqyrtoi qëndrueshmërinë ekonomike të hidrocentraleve të vogla, duke treguar se 70 për qind e fondeve për mbështetjen e energjisë së rinovueshme shkoi për hidrocentralet e vogla, ndërsa ato kontribuan 3,8 për qind në furnizimin me energji. Të dhënat që mblodhëm gjatë anketës treguan se mbështetja e qeverisë ishte më e favorshme për individët dhe kompanitë që janë pronarë të hidrocentraleve të vogla.

Eko-aktivistët theksojnë se hidrocentralet e vogla ndikojnë në nivelet e lumenjve dhe biodiversitetin. Ata pohojnë gjithashtu se hidrocentrale të vogla po ndërtohen në zona të mbrojtura dhe parqe kombëtare, në kundërshtim me rekomandimet e qeverisë. Eko-aktivistët besojnë se rritja e numrit të hidrocentraleve të vogla çon në uljen e nivelit të lumenjve, tharjen e tyre, ndryshimin e rrjedhës së ujit, që nga ana tjetër ndikon në biodiversitetin dhe është i rrezikshëm për mjedisin

## Këmbëngulja është çelësi për të arritur rezultate



Kur ekipi i gazetarëve të ISK-së hulumtuan temën e hidrocentraleve të vogla, ata u përballën me disa sfida. Institucionet publike nuk publikuan të dhëna për subvencionet, kishte vetëm pak ekspertë dhe aktivistë të shoqërisë civile që punonin në këtë temë dhe shumë pak mbulim mediatik. Me punë të palodhur dhe këmbëngulje, ekipi mundi të krijonte produkte mediatike që jepnin një pasqyrë të plotë të çështjes që po hulumtonim, kishin një audiencë të gjerë dhe provokoi përgjigje nga qeveria që rezultoi në publikimin e të dhënave për qëndrueshmërinë ekonomike të hidrocentraleve të vogla.

## Duhet të përfshihen të gjitha palët e interesuara

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjes së hidrocentraleve të vogla, të gjithë aktorët dhe persona relevantë u përfshinë në përmbajtjen mediatike dhe prezantuan pikëpamjet e tyre: ekspertë që punojnë në këtë temë, zyrtarë dhe pronarë të hidrocentraleve të vogla. Me këtë ne ndihmuam të forcohen argumentet, në të njëjtën kohë ekspertë, aktivistë dhe zyrtarë të kenë platformë për të diskutuar këtë temë ndërsa publiku të dëgjojë mendime të ndryshme. Kjo ishte një mundësi që ekspertët të paraqesin zgjidhje të ndryshme për burimet e rinovueshme të energjisë si kolektorët e erës dhe kolektorët diellor dhe të paraqesin pse është e nevojshme që qeveritë në rajon të investojnë në energjinë diellore, si një zgjidhje e qëndrueshme.

## Përvoja dhe partneriteti janë më të rëndësishmet për bashkëpunimin në tema nga rajoni

Pavarësia energjetike është dëshmuar të jetë një temë e përbashkët për vendet në rajon. DOMA prezantoi imazhin kombëtar të Maqedonisë së Veriut dhe prezantoi pikëpamjet nga rajoni për pavarësinë energjetike dhe burimet alternative të prodhimit të energjisë. Ekipi i DOMA prezantoi shembuj nga Serbia, si dhe nga Bosnja dhe Hercegovina, duke u përpjekur të gjejë përgjigje për tejkalimin e krizës energjetike në rajon. Hulumtimi tregoi se të dyja këto vende kanë një model të subvencionimit të hidrocentraleve të vogla dhe nuk përdorin burime alternative të energjisë. Duke pasur parasysh faktin se ISK ka përvojë në rajon nga më parë, ishte e lehtë të gjeesh partnerë dhe bashkëbisedues përkatës për të përgatitur storje cilësore mediatike nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

## Me të dhëna të qarta, përmbajtjet mediatike janë të pranueshme për audiencën

Të dhënat e detajuara dhe të paraqitura qartë ndihmojnë gjatë prezantimit të argumenteve të fuqishme për qëndrueshmërinë e ulët ekonomike të hidrocentraleve të vogla. Të dhënat u përkthyen në numra të lexueshëm, mesazhet u përpiluan në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, gjë që ndihmoi që përmbajtja mediatike të ishte lehtësisht e pranueshme për audiencën.

## Spektori i shoqërisë civile mund të ndryshojë mënyrën se si funksionojnë institucionet

Pas lajmeve të publikuara në platformën DOMA, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (ISHMJ) hapi hetim për funksionimin e hidrocentraleve të vogla që dyshohej se funksiononin në mënyrë të paligjshme. Drejtori i ISHMJ-së deklaroi publikisht se hidrocentralet e vogla që janë objekt përpunimi në dokumentarët e DOMA-s (HCV“Belica” dhe HCV“Leshnica”) kanë punuar në kundërshtim me ligjin ose kanë shkelur kushtet dhe procedurat e punës ndërsa Inspektorati planifikon të ndërmarrë masa kundër tyre, në mënyrë që të zgjidhet çështja për efektin e dëmshëm mbi mjedisin jetësor që e shkaktojnë hidrocentralet e vogla.

Gjetjet e ekipit të ISK-së u konfirmuan nga raporti për harmonizim, të përgatitur nga Enti Shtetëror i Revizionit, për shfrytëzimin e burimeve ujore në prodhimin e energjisë elektrike për periudhën 2012-2021. Raporti zbuloi se në periudhën 2012-2021 janë paguar 90 milionë euro për hidrocentralet e vogla, përkatësisht 40 milionë euro më shumë se vlera e tyre në treg, për shkak të tarifave të siguruara ligjërisht në bazë të kontratave

20-vjeçare, në kurriz të përdoruesve fundorë. Revizioni zbuloi se ka mungesë të qasjes sistematike në vlerësimin dhe dhënien e lejeve për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, mungesë koordinimi dhe kontroll të pamjaftueshëm nga institucionet kompetente. Fakti që nuk ka një sistem funksional për procedurat e vlerësimit, miratimit dhe mbikëqyrjes, si dhe as të dhëna dhe as një pasqyrë të plotë për funksionimin e hidrocentraleve të vogla, e vështirëson përcaktimin e përgjegjësisë. Rezultati është një pasqyrë e pasaktë e efektit që hidrocentralet e vogla kanë mbi mjedisin jetësor dhe për masat që duhen marrë për të mbrojtur burimet natyrore dhe biodiversitetin.



E gjithë kjo është në mbështetje të përpjekjeve për avokim dhe lobim të cilën e bën Aleanca “Kthjellohu”, të cilat kërkojnë, institucionet qeveritare të jenë transparente kur bëhet fjalë për hidrocentralet e vogla, pasi puna e tyre ka një ndikim më të gjerë në shoqëri, duke lidhur përgjegjshmërinë, cilësinë e jetës dhe mjedisin jetësor.



## **HISTORI SUKSESI: RAMPË PËR PALIGJSHMËRINË NË URBANIZËM DHE NDËRTIM**

Fushata për planifikim të duhur urban dhe mbrojtje të mjedisit, të cilën e kemi zhvilluar me organizatat e shoqërisë civile është shembull për rolin kryesor që mund të luajë sektori i shoqërisë civile në mbrojtjen e interesit publik.

Për dy dekadat e fundit, planifikimi urban në Shkup ka qenë një temë e diskutueshme. Pati pretendime për funksionim të paligjshëm të komunave, veçanërisht në zonën qendrore të qytetit të Shkupit. Ekspertët janë shprehur kundër planifikimit joadekuat urban dhe një sërë vendimesh të nxitura nga interesa politike apo biznes interesa dhe jo nga interesi publik.

Komuna Qendër e shpalli moratoriumin e ndërtimit në vitin 2017. Pas një ankese të paraqitur nga Oda e Ndërtimtarisë dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë vendimin për moratorium. Moratoriumi u rikthye shpejt me vendim të autoriteteve komunale, por kishte të bëjë vetëm për një numër të kufizuar kërkesash. Kjo ka mundësuar gjatë viteve 2020 dhe 2021 aktivizimin apo marrjen e lejeve të ndërtimit dhe fillimin e ndërtimit të disa objekteve në qendër të qytetit, shumë prej tyre të pasuara me reagime nga qytetarët.

Heqja e moratoriumit lejoi ndërtimin e ndërtesave shumëkatëshe pranë hotelit Holiday Inn, në një rast të dyshimtë që ngjalli polemika. Së bashku me organizatat e shoqërisë civile nisëm një fushatë kundër ndërtimit të ndërtesave të larta, duke qenë se për qytetarët u hapën dy çështje të rëndësishme - rritja e ndotjes dhe akuzat për funksionim të paligjshëm të institucioneve.





## Fushata na ndihmoi të arrijmë mësimet e mëposhtme:

### Sektori i shoqërisë civile ka fuqinë për të formësuar opinionin publik

Fushata që zhvilluam së bashku me organizatat e shoqërisë civile hapi një debat për planifikimin urban, tërhoqi mbulim të madh mediatik dhe rezultoi në nevojën që qytetarët të kërkojnë përgjigje nga institucionet qeveritare se si merren vendime që ndikojnë drejtpërdrejt mbi mjedisin dhe cilësinë e jetës. Fushata përbëhej nga këto aktivitete:


- Publikimi i roleve dhe përgjegjësive të institucioneve, në mënyrë që publiku të marrë informacion se ku qëndron përgjegjësia
- Njerëz me ndikim nga komuniteti akademik, sektori civil, media iu bashkuan fushatës kundër ndërtimit të ndërtesave shumëkatëshe
- Publikimi i një prezantimi të ndërtimit të planifikuar, me arkitektët që japin mendimet e tyre të kualifikuara, gjë që nxiti vëmendjen e publikut dhe të medias
- Kryetarët e Komunës Qendër dhe të Qytetit të Shkupit, si dhe ministri i Transportit, u detyruan të sqarojnë publikisht arsyet e vendimeve me të cilat lejohet ndërtimi
- Online- peticion, të cilin e mbështetën disa mijëra qytetarë

## Veprimi i përbashkët qytetar i ndihmon institucionet të bëhen të përgjegjshme

Organizata civile, në bashkëpunim me organizata partnere, mund të kërkojë dhe të marrë me sukses një përgjigje nga institucionet qeveritare. Fushata që zhvilluam me partnerët tanë mori mbështetje të gjerë publike dhe ngriti temën e planifikimit urban dhe mjedisit jetësor, në fokusin e raportimit mediatik. Kjo ngushtoi hapësirën për manovrim të institucioneve publike, të cilat duhej të shpjegonin publikisht arsyet e vendimeve që morën dhe sipas cilave procedura i kanë zhvilluar ato.

## Sektori i shoqërisë civile mund të kontribuojë në ndryshimet sociale

Fushata mori një mbulim të gjerë mediatik. Partneriteti me arkitektët dhe ekspertët ndihmoi në publikimin e një sasive të konsiderueshme të të dhënave dhe opinioneve të kualifikuara për mungesën e planifikimit të duhur urban në Shkup, si dhe një shpjegim se si vendimet komunale për planifikim urban ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve. Ndërprerja e moratoriumit dhe mosgatishmëria e institucioneve për të vepruar lejoi të vazhdojë ndërtimi jo përkatës. Megjithatë, për shkak të këmbënguljes në fushatë, qytetarët mësuan më shumë se si vendimet e komunave ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.



Mjedisi jetësor është kthyer në një temë popullore, një nga më kryesoret në programet e partive për zgjedhjet lokale 2021, ku për herë të parë pati një numër të konsiderueshëm të listave të pavarura të kandidatëve. Në disa komuna, si në Qendër, zëri i këshilltarëve të pavarur do të jetë faktor vendimtar në vendimet që marrin këshillat komunalë dhe kryetarët e komunave. Kjo tregon në praktikë ndikimin që mund të ketë sektori i shoqërisë civile në periudhën afatmesme dhe afatgjatë për të përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë të institucioneve.



## **PANDEMIA E KOVID-19 IMPONOI DINAMIKËN E VET DHE TEMA TË NDRYSHME ME INTERES PUBLIK**

Në Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) në përgjigje të pandemisë Kovid-19, kemi ndryshuar ndjeshëm mënyrën e funksionimit dhe në të njëjtën kohë kemi arritur të zbatojmë aktivitetet në kohën e duhur. Në pjesën më të madhe të punës, kemi përdorur mjete digjitale, ka pasur komunikim të shtuar me partnerët dhe një qasje fleksibël ndaj përmbytjes mediatike, ndërsa në të njëjtën kohë fokusi ka mbetur në çështjet e qeverisjes së mirë dhe pjesëmarrjes qytetare.

Në fillim të pandemisë, i vumë vetes synimin për t'u dhënë përgjigje pyetjeve me interes publik gjatë dhe pas gjendjes së jashtëzakonshme. Hulumtuam temat në lidhje me prokurimet publike, vendimet dhe urdhëresat e qeverisë në atë periudhë, rregullat e orës policore, trajtimin e pacientëve, vaksinimin. Jemi kujdesur që të marrim dhe t'u përgjigjemi pyetjeve të qytetarëve, kemi ofruar një gamë të gjerë pikëpamjesh të njerëzve nga mjekësia, arsimi, kultura. Publikuam numër të konsiderueshëm të përmbytjeve mediatike, ku dy të tretat e tyre i referohen pandemisë së Kovid-19.

Monitoruam transparencën e institucioneve qeveritare për të dhënat e publikuara për numrin e infeksioneve dhe masat për përballimin e pandemisë. Qëllimi ishte informimi, ndërgjegjësimi i publikut, edukimi i qytetarëve për Kovid-19 dhe ndërtimi i besimit mes qytetarëve, institucioneve dhe mediave.



## Puna gjatë pandemisë Kovid-19, na ndihmoi të nxjerrim mësimet si më poshtë:

### Përshtatuni ndryshimeve dhe rrethanave!

Duke filluar nga nëntori 2020, në ISK kemi filluar me trajnime për gazetarët e rinj. Për thirrjen e hapur në nivel kombëtar aplikuan 27 aplikantë dhe komisioni përzgjedhës përzgjodhi 22 pjesëmarrës. Trajnimi u zhvillua online, megjithëse plani fillestar ishte që të trajnoheshin 10 pjesëmarrës me prezencë fizike. Trajnimi u përshtat plotësisht në mënyrë që leksionet të mund të zhvillohen me përdorimin e mjeteve digjitale. Trajnuesit dhe pjesëmarrësit komunikuan përmes një intranet - sistemi të ofruar nga ISK. Shumica e pjesëmarrësve ishin në vitin e dytë ose të tretë të studimeve për gazetari dhe marrëdhënie me publikun, si dhe punonjës që punojnë me komunikime digjitale dhe duhet të përmirësojnë teknikat e tyre të të shkruarit. Ligjëratat u mbajtën nga gazetarë me përvojë, me përvojë shumëvjeçare profesionale në punën dhe menaxhimin e redaksive dhe ekipeve redaktuese në media.



Të udhëhequr nga angazhimi për të rritur ndërgjegjësimin për pasojat e pandemisë së Kovid-19, kemi përgatitur një buletin elektronik që përmbledh përmbajtjet në lidhje me pandeminë që u publikuan në platformën ResPublika. Buletini përmban përmbledhje të shkurtër të blogjeve, vlogjeve dhe podkasteve kryesore mbi tema që kanë të bëjnë me Kovid-19 dhe iu shpërnda institucioneve publike, OJQ-ve, mediave dhe komunitetit të studentëve.

## **Bëhuni gati për të panjohurën dhe të papriturën!**

Pandemia ka treguar se sa shpejt mund të ndodhë një ndryshim i madh në jetën dhe punën e njerëzve. Nga ata kërkohet të jenë të durueshëm, ndërsa nga organizatat të aktivizojnë planet për menaxhim me kriza.

Për shkak të përvojës së mëparshme me punën në krizë dhe portofolit të ndryshëm të aftësive që kanë të punësuarit në ISK, mundëm të riorganizohemi shpejt dhe të vazhdojmë të japim rezultate në përputhje me programin e punës. Nuk kemi reshtur me përgatitjen dhe publikimin e përmbajtjeve të reja. Përmbajtjet i kemi publikuar rregullisht në platformat DOMA, ResPublika dhe Vetëm Pyet. ISK-ja, ka marrë masat e nevojshme për sigurinë e punonjësve, ka punuar nga shtëpia, janë përdorur platforma digjitale për komunikim ndërsa rezultatet e punës kanë ruajtur cilësinë.

Shumë institucione publike në vend punuan me kapacitete të reduktuara, gjë që e bëri sfidë dhënien e përgjigjeve për pyetjet e qytetarëve në platformën “Vetëm Pyet”. Për shkak të

rrjetit të gjerë të institucioneve me të cilat ISK-ja, ka bashkëpunuar, nuk ka pasur vonesa në ofrimin e këtij shërbimi për qytetarët. Regjistri Qendror i Maqedonisë së Veriut madje na ka kontaktuar për bashkëpunim në pyetje të ndryshme që i marrin nga qytetarët, për t'i ndihmuar në dhënien e përgjigjeve.

## **Mirëqenia e punonjësve duhet të ruhet**

Pandemia shfaq nevojën për t'u fokusuar në burimet njerëzore dhe për të ruajtur kujdesin për punonjësit dhe mirëqenien e tyre. ISK është organizatë e përkushtuar me investimeve të vazhdueshme tek punonjësit e saj, duke u mundësuar punonjësve të punojnë në edukimin e tyre, të fitojnë aftësi të reja, të zgjerojnë njohuritë e tyre, të përmirësojnë zhvillimin personal dhe të mbajnë një ekuilibër ndërmjet punës dhe jetës private.



# 9 METODOLOGJIA

Analiza u përgatit me ndihmën e metodologjisë së krijuar për vlerësimin e mënyrës së zbatimit të projektit “Lidhi pikat”.

Ekspert i jashtëm për komunikime dhe shkrim, analizoi dokumentet e projektit. U shqyrtua dokumentacioni i plotë - dorëzimi i propozim - projektit, raportet narrative dhe financiare për zbatimin e tij, prezantimet për projektin dhe fushatën “Kthjellohu”, si dhe matrica më e fundit për rezultatet e projektit. Eksperti analizoi rastet studimore mbi arritjet e projektit, produktet mediatike të përgatitura gjatë projektit, si dhe raportimin e mediave për aktivitetet dhe rezultatet e projektit.

Projekti identifikon komponentët që janë zbatuar me sukses, si dhe disa shembuj të suksesshëm. Janë përzgjedhur shembuj që do të jenë pjesë e manualit për mësimet e nxjerra: urbanizmi - rasti i ndërtimit të ndërtesave shumëkatëshe përballë hotelit Holiday Inn, lejet dhe ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, bashkëpunimi rajonal për tema të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor dhe fushata për avokim dhe lobim “Kthjellohu”.

Ekipi i ISK mbajti disa diskutime të brendshme mbi mësimet e nxjerra nga zbatimi i projektit. Analizuam arritjet e projektit për të përcaktuar aktivitetet që rezultuan të suksesshme, ose ato që kanë nevojë për përmirësim në të ardhmen, si dhe aktivitetet që mund të aplikohen nga organizata të tjera.

Kemi përgatitur dhe shpërndarë pyetësor online për organizatat partnere në nivel kombëtar, si dhe për organizatat në rajon. Qëllimi ishte të merrnim informacion nga partnerët tanë për mundësitë e bashkëpunimit në projekt, të nxjerrim pikëpamje dhe përvoja të ndryshme. Hapi i fundit ishte shkrimi i analizës.

ISK beson se publikimi i kësaj analize për mësimet e nxjerra do të jetë e dobishme për organizatat e tjera të shoqërisë civile që planifikojnë të përgatisin dhe zbatojnë projekte që fokusohen në kujdesin për interesin publik, përmes proceseve të ndërtimit të koalicioneve, krijimin e nevojës për llogaridhënie të institucioneve dhe që kanë për qëllim ndryshimin e politikave të krijuara nga institucionet publike



# 10

## PROJEKTI PËRMES NUMRAVE

### Produkte mediatike të publikuara

**546** storje gazetareske

**335** blogje - të publikuara rregullisht nga 16 partnerë mediatikë në mbarë vendin

**54** vlogje

**152** produkte mediatike që përmbajnë komponentë gjinore

**24** podkaste

**18** dokumentarë


**42** intervista

**23** histori hulumtuese multimediale

**88%** opërqind e produkteve mediatike janë shpërndarë nga media kombëtare

**54%** përqind nga mediat rajon





Janë përgatitur dhe publikuar **6** dokumente për politika  
Pjesëmarrje në procesin e konsultimeve për **4** zgjidhje ligjore  
Janë realizuar **2** trajnime për avokim dhe lobim  
Kanë përfunduar **2** module trajnimi për gazetarët e rinj  
Është realizuar trajnim për **22** gazetarë të rinj

**Botues:**

**Instituti për studime komunikative**

**rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup**

**[www.iks.edu.mk](http://www.iks.edu.mk)**


**Për botuesin: Profesor i Asociuar dr Zhaneta Trajkoska**

**Botim: ResPublica**

**Përktheu: Vjosa Taipi**

**Dizajn grafik: Zoran Cardula**





**ИКС** Институт за  
комуникациски студии

Instituti për Studime të Komunikimit  
Rr. "Jurij Gagarin" 17-1 / 1, Shkup  
info@iks.edu.mk; 02 30 90 004  
www.iks.edu.mk



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Lidhi pikat: Politika të përmirësuara përmes pjesëmarrjes qytetare" financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.